



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2018:042226  
Datë: 19.09.2018  
Numri i dokumentit: 00125677

P.nr. 882/16

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN** - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Luljete Shabani, me praktikanten Edona Selimi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit **M.R.** nga fsh. ... K. e ..., të cilin me autorizim e mbronë av. B.H., për shkak të veprës penale, **Lidhja e paautorizuar ne shërbime nga neni 321 i KPRK-së**, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, PP.II.nr.1294/16, e datës 19.07.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar e publik, më datën 13.09.2018, mori dhe në prezencë të palëve shpallë, ndërsa, më datën 19.09.2018, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari M.R.**, nga babai K. dhe nëna A., e lindur M., i lindur me datë ... në Gjilan, jeton në fsh. ..., K. e ..., i martuar, baba i tre fëmijëve, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar edhe më parë dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penale ndaj tij,

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse, prej datës 09.02.2016, në kohë të papërcaktuar dhe në vazhdimsi, në shtëpinë e tij, si konsumator i energjisë elektrike, me qëllim që vetit t'i sjellë pasuri të kundërligjshme, ka përfituar nga shërbimet komunale, në atë mënyrë që nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it gjate kontrollit është konstatuar që i pandehuri është lidhur direkt pa njehsor elektrik dhe ka shfrytëzuar energjinë elektrike, edhe pse më parë ka një drite të lidhur drejtpërdrejt në rrjetin elektrik, para pikes matese, ku energjia e shpenzuar, për shkak të borxhit që kishte ndaj KEDS-it, ia kishin konfiskuar njehsorin elektrik, me çka, ka pamundësuar regjistrimin e shpenzimeve të energjisë elektrike dhe të dëmtuarës KEDS-it, Distribuimi në Gjilan, i ka shkaktuar dem material në shume prej 81.83 €,

- me çka ka kryer veprën penale, **Lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 të KPRK-së**, andaj Gjykata, bazuar në dispozitat e neneve 7, 17, 21, 51, 73, 114 të KPRK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i shqipton:

## **DËNIM KUMULATIV, ME GJOBË DHE ME KUSHT**

**Dënim me Gjobë** në shumë prej **200 (dyqind) €**, të cilën gjobë i akuzuari do ta paguajë menjehere pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe

**Dënim me Burg – me kusht** në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditësh**, i cili denim nuk do te ekzekutohet nese i akuzuari ne periudhen verifikuese prej **1 (nje) viti** nuk kryen veper tjeter penale, ne te kunderten Gjykata denimin me kusht do ta revokoje

Në bazë të nenit 39 par.4 nënpar. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të akuzuarit i shqiptohet taksa në shumën prej **30 (tridhjetë) €**.

**Obligohet** i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej **20 (njëzet) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë PP.II nr. 1294/2016, e datës 02.07.2016, kundër të akuzuarit M.R., për veprën penale, **Lidhja e paautorizuar ne sherbime nga neni 321 i KPRK-së** dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, përmes Prokurorit të Shtetit, Ismet Ukshini, ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me të pandehurin M.R. dhe mbrojtësin e tij, av. B.H.

Prokurori i shtetit, Ismet Ukshini, në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë të mbajtur më datë 13.07.2018, deklaroi se për një gjë të tillë kanë pasur autorizim edhe nga kryeprokurori dhe këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e kanë nënshkruar së bashku duke përfshirë këtu kryeprokurorin, të pandehurin, mbrojtësen e saj dhe prokurori në fjalë, andaj, kërkojnë nga gjykata që ta pranojë marrëveshjen me nr. PP.II.nr.2105/2016, të datës 13.07.2018.

Mbrojtësja e të pandehurit, av. B.H., deklaroi se mbetet pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe kërkoi nga gjykata që ta pranojë këtë marrëveshje.

I pandehuri M.R. deklaroi se e mbështet në tërësi deklaratën e mbrojtëses së tij, pasi që marrëveshjen për pranimin e fajësisë e ka nënshkruar në mënyrë vullnetare, i vetëdijshëm se çka përmban e njëjta, paraprakisht është konsultuar me mbrojtësen e tij, është pënduar për kryerjen e kësaj vepre penale ndërsa nuk ka qenë i kërcënuar apo mashtruar për ta nënshkruar këtë marrëveshje, andaj edhe ky kërkoi nga kjo gjykatë që ta pranojë këtë marrëveshje. Gjithashtu deklaroi se është pënduar dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm të mos bie ndesh me ligjin.

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë, mori aktvendim me të cilin e pranoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, dhe i njoftoi palët se pasi që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është arritur me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë, nuk i

lejohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, e as prokurorit të shtetit që të tërhiqen nga kjo marrëveshje mbi pranimin e fajësisë pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara në nenin 233 par. 18 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari pati sjellje korrekte në Gjykatë, pranimin e fajësisë, se është penduar për veprën në fjalë, ndërsa si rrethanë rënduese, mori faktin se këto vepra penale janë bërë dukuri shumë e shpeshtë kohëve të fundit, me bindje se një dënim i tillë është ne përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës, duke qenë e bindur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2018:042226, 19.09.2018**

**Praktikanja,**  
Edona Selimi

**Gjykatësja e vetme gjyquese,**  
Luljete Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Palët kanë hequr dorë nga ankesa kundër këtij aktgjykimi.